



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Autoriteti Kombëtar Për Certifikimin Elektronik

UDHËZIM
PËR DOKUMENTACION E REGJISTRIMIT TË
OFRUESIT TË KUALIFIKUAR TË SHËRBIMIT TË BESUAR



Udhëzim nr.1
Versioni 1.1
Buletini 2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK

UDHËZIM NR. 1

PËR DOKUMENTACION E REGJISTRIMIT TË OFRUESIT TË
KUALIFIKUAR TË SHËRBIMIT TË BESUAR

Në mbështetje të Ligjit nr. 9880 datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar, Ligjit nr. 107/2015, datë 1.10.2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 69, datë 27.1.2016 “Për miratimin e rregullores për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik,

UDHËZON:

Të gjithë personat fizikë ose juridikë, që duan të regjistrohen pranë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE), për të përfituar statusin si Ofrues të Kualifikuar të Shërbimeve të Besuara, duhet të paraqesin dokumentacionin ligjor, financiar dhe teknik, si më poshtë:

Dokumentacioni ligjor përfshin:

1. Dokument lëshuar nga Gjykata që vërteton se, personi nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për ndonjë nga veprat e parashikuara në rregulloren “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, pjesa III “Kushtet ligjore, teknike, profesionale dhe financiare”, pika 4 “Besueshmëria ligjore”;
2. Ekstrakt me të dhënat e subjektit, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit për regjistrimin e biznesit, (statusi aktiv);
3. Dokument që vërteton se, subjekti nuk është në proces falimentimi dhe kapitalet e tij nuk janë në duar të përmbarimit dhe në proces konfiskimi (Ekstrakti historik);
4. Dokument të lëshuar nga Administrata Tatimore, që vërteton se subjekti:
 - a) ka plotësuar detyrimet fiskale;
 - b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore.

Këto kritere (pikat 1 – 4) duhet të vërtetohen përmes dokumenteve të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e aplikimit.

Dokumentacioni financiar përfshin:

1. Depozitë ose garanci të lëshuar nga një bankë ose policë sigurimi pa kusht, të lëshuar nga një shoqëri e liçencuar në fushën e sigurimeve dhe që mbulon edhe këtë kategori shërbimi. Garancitë financiare duhet të jenë të vlefshme përgjatë gjithë kohës së aktivitetit të ofruesit të shërbimit dhe në përputhje me pikën 7 të rregullores “Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara” miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 69 datë 27.1.2016.

Dokumentacioni teknik përfshin:

1. Politika e Certifikatave/Certificate Policy, dokument i cili përfshin të gjitha rregullat dhe praktikatat për besueshmërinë e veprimtarisë së lëshimit të certifikatave të kualifikuara, për nënshkrimin elektronik, identifikimin elektronik, vulave elektronike, sistemin e transmetimit elektronik dhe certifikatat për autentifikimin e faqeve të internetit.

2. Deklarata e Praktikave të Certifikatave/Certificate Practice Statement, dokument i cili përshkruan praktikatat dhe procedurat e përdorura për të adresuar të gjithë kërkesat e identifikuara në Politikën e Certifikatave.

3. Dokumenti i politikave të sigurisë së informacionit/Security Policy, dokument i cili përcakton përjashtjen e ofruesit të kualifikuar të shërbimit të besuar për menaxhimin e sigurisë së informacionit të tij.

4. Certifikatat e prodhuesit, të pajisjeve apo sistemeve kriptografike, që do të përdoren për ofrimin e shërbimeve të besuara.

5. Format kontrata mbi termat dhe kushtet e përdorimit të certifikatave të kualifikuara, e cila lidhet ndërmjet OKSHB dhe zotëruesve të certifikatave.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 8.2.2016